



E enjte,
1 shkurt 2007

Gazetë e
përditshme

32
FAQE

Iliria Post



Çmimi
0.20 €
Viti II • Nr 315

www.iliriapost.net



Kryeprokurorja e Hagës do të largohet nga posti | FAQE 2

Stiven Schook përkrahë planet e Ministrisë së Shëndetësisë

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk i mbulon nevojat e të gjitha fushave në Kosovë dhe nuk mjafton për të gjitha nevojat e saj, por buxheti tashmë është miratuar dhe ne duhet të ballafaqohemi me realitetin, tha Schook | FAQE 5

Parisi do të ndihmojë konsensusin për statusin e Kosovës | FAQE 4



Bildt: Periudha e bisedimeve nuk do të jetë e lehtë

Sejdiu tha se hapja e pakos duhet ta përshpejtojë njohjen e pavarësisë së Kosovës, kurse Çeku zotohet se nuk do të ketë shtyrje të statusit final për Kosovën

Nuhi LLUGAXHIU

Prishtinë, 31 janar - Diplomati suedez Karl Bildt vizitoi sot Kosovën, ku u takua me përfaqësuesit institucionalë të vendit. Pas takimeve me presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe me kryeministrin Agim Çeku, potencoi se periudha e bisedimeve rreth pakos së Ahtisari nuk do të jetë e lehtë. Megjithatë ai konsideron se ky proces gjatë kësaj periudhe do të jetë shumë i rëndësishëm, si për Kosovën ashtu dhe për Serbinë. Suedia dhe të gjitha vendet e BE së, tha ai, janë në pritje të propozimit të presidentit Ahtisari. Më pas do të dëgjohej qëndrimi i Prishtinës dhe Beogradit dhe vendimi i Këshillit të Sigurimit të OKB së, që do ta qartësojë këtë qëndrim.

Bildt nuk pranoi të komentojë propozimin e z. Ahtisaari, për shkak, siç tha ai, të respektit për procesin. Bildt mes tjerash vuri në pah se punët e rëndësishme kanë të bëjnë me çështjet pas statusit, atëherë kur do të vendoset për të ardhmen dhe fatin e Kosovës, dhe në veçanti me çështjet ekonomike. Pjesa e madhe e ekonomisë kosovare, siç vërejt ai, varet nga të hyrat që vijnë nga shtetet e jashtme në mënyra të ndryshme. "Me të vërtetë ekonomia varet nga reformat në vitet që po vijnë në Kosovë", tha ai. Si prioritet për Kosovën Bildt theksoi krijimin e vendeve të reja të punës, që, sipas tij, "është një nga çështjet që do të definojë stabilitetin dhe suksesin në Kosovë në vitet që po vijnë". Ndërkaq, presidenti Sejdiu tha se "E shtrona nevojën që pas hapjes së pakos së Ahtisari procesi të ecë më shpejt dhe të përfundojë mirë

me pavarësinë e Kosovës dhe njohjen e saj ndërkombëtare dhe përnjë nevojë më të madhe në shtimin e komunikimeve edhe për zhvillimin ekonomik". Sejdiu tha se Kosova ka nevojë të dëshmojë si një vend demokratik, i cili aspiron të ndërtojë brenda saj vlerat e demokracisë perëndimore. Kryeministri i vendit Agim Çeku, pas takimit me ministrin e Jashtëm të Suedisë, Karl Bildt, përjashtoi çdo mundësi të shtyrjes së statusit final për Kosovën, ngase një proces i tillë do të shkonte në dëm të qytetarëve të Kosovës. Ai theksoi se procesi i statusit duhet të zhvillohet me dinamikën e paraparë dhe se nuk ka asnjë arsye për shtyrje të tij. "Mendojmë se Ahtisari, pasi t'i dëgjojë komentet tona, në afatin sa më të shkurter, do ta dorëzojë propozimin dhe rekomandimet e tij në Këshillin e Sigurimit dhe pastaj KS ta ndërtojë një rezolutë me të cilën do të njihet Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Çdo shtyrje do të ishte e papranueshme, e paarsyeshme dhe e panevojshme", tha Çeku, i bindur se nuk do të ketë më shtyrje të procesit për statusin politik të Kosovës.

Kryediplomati suedez Bildt, takoi sot edhe kryetarin e ORA-s, Veton Surroi, me të cilin tha se ka diskutuar për procesin e bisedimeve për statusin e Kosovës, respektivisht për zhvillimet që pritet të ndodhin në periudhën në vijim. Surroi shprehu qëndrimin e Delegacionit të Kosovës se procesi duhet të vazhdojë pa zvarritje të mëtejshme duke kërkuar që në afatin sa më të shpejtë çështja e Kosovës të vihet në rendin e ditës së Këshillit të Sigurimit. "Ne nuk mund të presim formimin e qeverive, zvarritjet dhe kombinimet e ndryshme, të cilat sajohen në Beograd. Kërkojmë që procesi i statusit të Kosovës të arrijë sa më shpejtë në Këshillin e Sigurimit", deklaroi Surroi. Ai kërkoj që zgjidhja e statusit të Kosovës të jetë e qartë dhe pa dykuptimësi. Surroi dhe Bildt thanë se janë pajtuar që Delegacioni i Kosovës duhet ta mirëpresë presidentin Ahtisaari, i cili pritet të sjellë të premtën me 2 shkurt pakon, si propozim



Diplomati suedez Karl Bildt (foto: Xifa)

për zgjidhje e statusit të Kosovës.

Diplomati Suedez është zotuar se Bashkimi Evropian do të japë një qëndrim unik për Kosovën, ngase sipas tij BE-ja ka një rol shumë të rëndësishëm në zhvilli-

min e proceseve në Kosovë.

Ministri Bildt gjatë ditës është takuar edhe me shefin e UNMIK-ut Joakim Ryker si dhe me përfaqësues të tjerë institucionale e politike të vendit.

Letër e hapur e intelektualëve mbi zhvillimet aktuale lidhur me statusin e Kosovës

Institucioneve ndërkombëtare dhe vendëse

Pas një shekulli vështirësish zhvillimi nën pushtimin e Serbisë/Jugosllavisë, pas përvojave të përsëritura të përndjekjes, të shpërnguljeve të dhunshme, të mohimit të të drejtave themelore, pas aparteidit dhe gjenocidit të ricikluar, në vijim të lëvizjes së madhe paqësore e të armatosur për çlirim të vendit, me ndërhyrjen e NATO-s e të Kombeve të Bashkuara dhe me angazhimin e posaçëm të SHBA-ve, populli i Kosovës ia doli të çlirohet nga dhuna ekstreme e Serbisë. I gatshëm të bashkëpunonte me bashkësinë ndërkombëtare, ky popull i respektoi marrëveshjet dhe obligimet që ia shtroi përpara kjo bashkësi në drejtim të zhvillimeve integruese. Shkallën e lartë të disiplinës dhe të përkushtimit në këtë drejtim e shpjegon vetëm motivimi për të arritur gjënë më të shtrenjtë – lirinë. Kjo bëri që administrimi ndërkombëtar në Kosovë të kalonte vite me qetësi. Në sajë të vullnetit të qytetarëve dhe ndihmës së ofruar nga institucionet ndërkombëtare u shënuan suksese në fusha të ndryshme të jetës: pas kthimit masiv të më shumë se një milion njerëzve të shpërngulur me dhunë, u ndërmorën hapa për rindërtimin e vendit, për ndërtimin e organizimit shoqëror e shtetëror, për rimëkëmbjen e sistemit arsimor, të administratës e të shërbimeve, të policisë e të segmenteve të sigurisë. Ka pasur nisma në fushën e zhvillimit ekonomik, por nuk mund të thuhet se u arritën suksese të shënueshme për zvogëlimin e papunësisë, për hapjen e ciklit të investimeve, për integrimin e institucioneve në mekanizmat ndërkombëtarë, për mbrojtjen e qytetarëve jashtë vendit, për raportet me vendet e tjera, për luftimin e korrupsionit dhe të krimin të organizuar. Me gjithë zgjedhjet demokratike dhe konstituintimin e pushtetit të dalë prej tyre, nuk u shënuan suksese në eliminimin e strukturave paralele të Serbisë. Pjesë të tëra të Kosovës mbeten të paarritshme për qytetarët e saj...

5»

PE paraqet draftin që Kosovës t'i garantohet një pavarësi

BRUKSEL, 31 JANAR - Deputeti i të gjelbërve holandezë, Jost Lagendijk, paraqiti në Parlamentin Evropian draftin e raportit për Kosovën. Ky raport sugjeron që Kosovës t'i garantohet një pavarësi, ndërsa sovraniteti do të kufizohet për një kohë të caktuar me praninë ndërkombëtare të BE-së dhe NATO-s. Po ashtu, dokumenti i Parlamentit Evropian nënvizon se ka dëme të mëdha në rast të shtyrjes së statusit dhe se status-quoja nuk mund të mbahet. Po ashtu, ky dokument nënvizon se BE-ja duhet të ketë një rol kyç edhe në implementimin e marrëveshjes së statusit dhe se duke pasur parasysh gjithë atë që ka ndodhur, është e paimagjinueshme që Kosova të kthehet nën ndikimin e Beogradit.



Ekipi, edhe pse me vonesë, premtan transparencë

NATO-ja e përgatitur në rast të revoltës së serbëve në veri

PRISHTINË, 31 JANAR - "NATO-ja është e përgatitur për rastin e skenarit më të keq të dhunës rajonale në rast të revoltës së serbëve në veri të Kosovës përkatimi me vendimin e shpejtë për fatin e Kosovës", kështu u shpreh komandanti i KFOR-it, Rolan Kater.

"Nëse diçka ndodh në veri, ne do të kemi diçka sikur një domino-efekt", i tha gjenerali Kater agjencisë "Reuters" dhe shtoi: "Ne do të kemi probleme të njëjta në Luginën e Preshevës". Ai më tutje tha se veriu i Kosovës, ku serbët përbëjnë shumicën dhe po kërcënojnë me ndarjen e tyre, do ta ketë kujdesin e tij të veçantë. "KFOR-i e ka rihapur bazën veriore vitin e kaluar për të qenë i gatshëm për çdo gjë që mund të ndodhë", tha gjenerali Kater.



Hapat e tjerë të Kosovës

Paqja, në një formë ka ardhur në Kosovë por statusi i saj mbetet i paqartë. Ka shpresa, megjithëse, zhvillimet e reja pozitive shkojnë në ditët e ardhshme, shkruan në komentin e tij në "Guardian Unlimited", Michael Moore, diplomati i lartë në partinë liberale në Angli...

nga brendia»

MOTI MIN °C MAX °C

Prishtinë	Sot	Nesër	Pasnesër
	-2 7	-2 8	-5 1
Tiranë			
	2 14	3 14	-1 11
Shkup			
	-5 8	-4 8	-5 4

NË ILIRIA POST

Shtojca
Tinky
Winky
në 2 faqe

FAQE 24-25

WWW Më shumë informata mbi përmbajtjen e gazetës në www.iliriapost.net

CMYK

E brendshme



Falë gjakut të dëshmorëve Kosova po e fiton shtetësinë

Në dhjetëvjetorin e rënies së dëshmorëve të kombit Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, u tha se falë gjakut dhe veprës së tyre qytetarët e Kosovës tani po e gëzojnë shtetin

Ilir MUÇAJ

PRISHTINË, 31 JANAR - Me rastin e dhjetëvjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, në Teatrin Kombëtar u organizua një akademi

përkujtimore kushtuar jetës dhe veprës së këtyre dëshmorëve. Në këtë akademi morën pjesë personalitete të larta të jetës politike dhe publike të Kosovës. Kryeministri Agim Çeku me këtë rast tha se sa më shumë që po afrohet dita e madhe e pavarësisë, më pranë i kemi idealet e dëshmorëve dhe aq më të ndritshme po bëhen veprat e tyre. "Këto ideale bëhen edhe më të prekshme sot, kur po nderojmë veprën dhe heroizmin e dëshmorëve të kombit Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, të cilët 10 vjet më parë bënë histori", tha Çeku. Kryeministri tha se ne duhet të jemi mirënjohës dhe falënderues dëshmorëve dhe të rënëve të kombit, sepse siç tha Çeku pa sakrificën dhe flijimin e tyre, Kosova vështirë se do të mbërinte këtu ku është sot, e lirë dhe e gatshme për ta pritur ditën e pavarë-

sisë. "Duke nderuar kujtimin e dëshmorëve dhe të të rënëve për liri, ne kryejmë një obligim moral dhe e forcojmë edhe më shumë lidhjen me të kaluarën e lavdishme, e cila është bazament në të cilin do të mbështetemi kurdoherë", tha Çeku. Sipas kryeministrit me vendimin për statusin do të përfillen sakrificat e popullit tonë për liri dhe do të jetë në përputhje me vullnetin e qytetarëve, siç nënvizoi ai, për të jetuar të lirë dhe të pavarur si të gjithë popujt tjerë. "Ne besojmë se këtë vullnet do ta respektojë edhe pakoja e Ahtisaarit, pavarësisht gjuhës dhe terminologjisë diplomatike që do të përdorë ai. Kosova përfundimisht do të jetë e pavarur, sepse e drejta dhe argumentet janë në anën tonë. Argumente më të fuqishme për pavarësinë se dëshmorët që po nderojmë sot dhe të gjithë dëshmorët

dhe martirët që ranë për Kosovën nuk mund të gjenden", tha Çeku, duke shtuar se liria dhe pavarësia e Kosovës ka nënshkrimin dhe vullën e gjakut të dëshmorëve. Ndërsa, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Hashim Thaçi, tha se falë luftës së heronjve Kosova është në prag të formimit të shtetit të saj. "Sot, kushtimi i gjithë luftëtarëve na bashkon për sfidat që do të na presin, vepra e tyre është përkushtim që na bashkon dhe na mobilizon për përkushtimet e ardhshme, ne kemi nevojë për unitet në proceset që po kalojmë në bërjen e shtetit të tyre dhe të realizojmë amanetin e dëshmorëve që në Kosovë çdo qytetar ta ndjejë vetën të sigurt dhe të barabartë", tha Thaçi. Ai tha se do ta ndërtojë edhe një Kosovë me ushtri më profesionale dhe së shpejti me ulëse në OKB, me simbole kom-

bëtare dhe flamur që do të valojë në po ashtu në OKB. Ndërkaq, komandanti i TMK-së, gjeneraljettënant Sylejman Selimi, tha se rënia vrasja e këtyre djemve ishte humbje e madhe për popullin dhe UÇK-në, por, siç tha ai, ngjarjet që do të vinin pas do të tregonin jehonën që pat rënia heroike e tyre. "Me luftën e tij Zahir fitoi vlerat e një luftëtari, duke u bërë simbol i sakrificës për liri. Sot jemë krenarë dhe të vetëdijshëm për fazën që po kalojmë. Për asnjë çast nuk do të largohemi nga porosia që na lanë dëshmorët tanë: Kosova do ta ketë forcën e vet mbrojtëse", tha Selimi. Në këtë solemnitet qenë të pranishëm edhe familjarët e të rënëve dhe shumë figura të rëndësishme të vendit. Në nderim të dëshmorëve shumë personalitete bënë homazhe para lapidarit të Zahir Pajazitit në Prishtinë.

Rishikimi i mangët i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë

Dje, pas një viti pune, në mënyrë të qetë u publikuan rezultatet e rishikimit të sektorit për siguri të brendshme në Kosovë, i drejtuar nga KB-ja. Si përgjigje e shpejtë ndaj raportit përfundimtar të rishikimit, Saferworld dhe Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) shprehin shqetësimet rreth hapësirës së ngushtë të rishikimit dhe këshillimeve të kufizuara me publikun kosovar si dhe dështimit në marrjen parasysh të çështjeve thelbësore të rajonit, të gjitha këto që ndikojnë në zbehjen e rëndësisë së këtij raportit.

"RSSB-ja ka dhënë disa rekomandime të mira përkundër kushteve të vështira, por as procesi i shtrenjtë i rishikimit dhe as publikimi i propozimeve të tij nuk i janë nënshtruar shqyrtimit real të publikut dhe parlamentit. Ndërmjet spekulimeve lidhur me propozimet e të Dërguarit Special të KB-së Martti Ahtisaari për statusin përfundimtar, nuk është e qartë se çfarë përfitime do të ketë populli i Kosovës nga ky raport 2 milionë dollarësh i RSSB-së", u shpreh Claire Hickson, kryesuese për komunikim, Saferworld.

Marrja e hapave të sigurt për përmirësimin e sigurisë në Kosovë do të jetë kritike për të ardhmen e Kosovës, pasi të jetë përcaktuar statusi i saj. Rishikimi filloi më këshillimet publike mbi kërcënimet e sigurisë me të cilat përballlet Kosova, dhe ishte më

ambicioz në këtë drejtim se proceset tjera kudo në botë. Sidoqoftë, përkundër shenjave inkurajuese, procesi u pengua nga një dështim në qasjen e shënimeve të nevojshme dhe perceptimet, kuptimin e çështjeve të rajonit, ose provimin e rezultateve të tij jashtë Komisionit Drejtues.

Megjithatë, nuk ka shumë për të lavdëruar në këtë raport. Ky është shqyrtimi i parë gjithëpërfshirës i normave të sigurisë në Kosovë, duke mbuluar kështu të gjitha fushat, prej policisë tek shërbimet emergjente civile si dhe shëndetësinë dhe ekonominë. Raporti saktësisht përshkruan problemet më shqetësuese të Kosovës, si ekonominë të përcjellë nga papunësia e madhe, si një nga shkaqet kryesore të pasigurisë. Shumë nga rekomandimet e tij mbi sistemin e sigurisë – si propozimi për krijimin e shërbimeve inteligjente vendore (Shërbimi i Sigurisë i Kosovës), Forcat Mbrojtëse të Kosovës dhe Këshillin Kombëtar të Sigurisë – janë të vështira dhe sfiduese. Rekomandimet tjera si,

shpërndarja graduale e Trupave Mbrojtëse të Kosovës tashmë janë shumë të vonuara.

Sidoqoftë, rekomandimet dhe konkludimet e raportit janë të pamjaftueshme në disa aspekte.

Hulumtimi anon shumë drejt çështjeve të brendshme, dhe nuk merr

parasysh ndërlikimet rajonale të propozimeve të tij, edhe pse çështjet e qeverisjes së sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë luajtën një rol qendror në nxitjen e konfliktit të vitit 1999, dhe ende vazhdojnë të kenë rëndësi të madhe simbolike në dialogun në mes Beogradit dhe Prishtinës.

Qëndrueshmëria dhe efikasiteti afatgjatë i këtyre propozimeve kërkon përfshirjen dhe angazhimin e vetë Kosovareve.

Kultura politike e Kosovës, pesimizmi dhe frustrimi aktual në lidhje me papunësinë e madhe, pasigurinë dhe paqartësinë në lidhje me të ardhmen, janë me siguri sfidat më të mëdha për çfarëdo procesi politik në Kosovë. RSSB-ja i shmang në masë të madhe këto çështje, duke u përqendruar më shumë në institucionet dhe proceset ligjore formale.

Siguria e re e Kosovës nuk do të përmirësohet derisa Kosovaret t' u besojnë atyre që kanë për detyrë të garantojnë sigurinë e tyre. Kështu, implementimi i këtij raportit duhet të përgatitet për problemet. Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë, UNDP-ja në Kosovë, u komisionua nga ish-Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së (PSSP), Soren Jessen-Petersen.

Saferworld rekomandon që Misioni i KB-së në Kosovë dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse relevante

në Kosovë të sigurojnë që komisioni i ri drejtues të përfaqësojë Kosovaret dhe të jetë përgjegjës ndaj tyre; Të drejtojnë një analizë mbi konfliktin e pjesëmarrjes në Kosovë dhe mbarë rajonin për të shqyrtuar shkaqet themelore të konfliktit dhe pasigurisë, dhe të identifikojnë mënyrat për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative të reformave pasuese në tensionet ekzistuese të konfliktit. Analiza duhet të përfshijë një sferë të gjerë të mbështetësve nga Kosova si dhe mbarë rajoni;

Të mbajnë këshillime publike në secilën fazë të implementimit të RSSB-së, duke filluar kështu me qasjen në rekomandimet specifike të përfshira në RSSB, dhe zhvillimin e 'letrave të bardha' mbi çështjet specifike për rishikimin e parlamentit dhe publikut; T'i kushtojnë më shumë rëndësi

qasjes ndër-sektoriale drejt përmirësimit të sigurisë në

Kosovë, duke lidhur sigurinë me qeverisjen afatgjatë dhe programet zhvillimore.

Këtë vit, Bashkimi Evropian pritet të nis misionin e tij në Kosovë. Kriteret për këtë mision, i cili është më i madhi i krijuar deri më sot nën Politikën Evropiane mbi Sigurinë dhe Mbrojtjen, janë duke u diskutuar tani për tani. Është thelbësore që BE-ja të përkrah procesin e një reforme më përfaqësuese dhe reale, duke siguruar që Kosovaret të jenë të përfshirë plotësisht në vendimet e ardhme mbi reformën e shërbimeve të sigurisë; dinamikat rajonale janë marrë parasysh në kompozimin dhe implementimin e proceseve të RSSB-së; dhe të adresohen shkaqet themelore të tensioneve në Kosovë, si varfëria dhe papunësia.

Përkujtohen tre dëshmorët e shkollës shqipe

ISTOG, 31 JANAR - Me një solemnitet rasti, të organizuar të mërkurën në fshatin Uçë të Istogut, u shënua dita e shkollës "Tre dëshmorët e shkollës shqipe", dhe 15-vjetori i rënies heroike të dëshmorëve Muharrem Imeraj,

Bajram Hoxha dhe Hasan Hysenaj. Në këtë solemnitet morën pjesë ministri i Arsimit, i Shkencës e i Teknologjisë, Agim Veliu, përfaqësues të pushtetit lokal, të KFOR-it dhe banorë të këtij fshati.